

VENDIM
Nr. 842, datë 28.10.2020

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI: “REHABILITIMI I ZONËS FUNDORE TË SHESHIT ‘SANTA BARBARA’ DHE NDËRTIMI I GODINËS SË BASHKISË DIVJAKË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti: “Rehabilitimi i zonës fundore të sheshit ‘Santa Barbara’ dhe ndërtimi i godinës së Bashkisë Divjakë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Divjakë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë të përgjithshme prej 4 254 172.81 (katër milionë e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 4 254 172.81 (katër milionë e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë e një) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Divjakë.

5. Shpenzimet procedurale në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tri) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Bashkisë Divjakë.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Divjakë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, e të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Divjakë.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Divjakë.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Divjakë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

TABELA E PRONARËVE PRIVATË QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT: “REHABILITIMI I ZONËS FUNDORË TË SHESHIT
‘SANTA BARBARA’ DHE NDËRTIMI I GODINËS SË BASHKISË DIVJAKË

Nr.	Emër, Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e përgj. e truallit m ²	Sip. e prekur e truallit në m ²	Çmimi për truall (lekë/m ²)	Vlera e truallit	Sipërfaqja e ndërtimit në kartelë	Sip. e ndërtesës sipas faktit (m ²)		Sip. e prekur e ndërtesës (m ²)	Sipërfaqja totale e ndërtesës që shpronësohet (m ²)	Vlera e ndërtesës (lekë)	Vlera e përgjithshme truall + ndërtesë (lekë)	Gjendja juridike	Statusi juridik
									Kati shërbim (m ²)							
									Kati përdhe (m ²)	Kati I (m ²)						
1	Filip Gorreja, Natasha Gorreja	1492	630/83	190	190	514	97,660.0	173	145	0	145	145	2,504,646.52	2,602,306.52	Konfirmim ASHK	Nuk ka shënime
2	Filip Gorreja, Natasha Gorreja	1492	630/98	310	310	514	159,340.0	0	0	0	0	0	-	159,340.00	Konfirmim ASHK	Nuk ka shënime
3	Nerenxe Mehmeti	1492	630/88	120	120	514	61,680.0	120	107	0	107	107	910,158.08	971,838.08	Konfirmim ASHK	Nuk ka shënime
4	Prokop Vodo	1492	630/78	42	42	514	21,588.0	42	42	0	42	42	499,100.21	520,688.21	Konfirmim ASHK	Nuk ka shënime
Vlera totale														4,254,172.81		